



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 10, Datë 10.01.2018

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC-i DRAGOSTUNJE” SH.P.K.,  
PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË LUAJTSHME DHE VENDOSJE TË  
HIPOTEKËS MBI ATO TË PALUAJTSHME QË DO T’I PËRKASIN “HEC –I  
DRAGOSTUNJE”, (ASETE QË DO TI SHËRBEJNË VEPRIMTARISË SË  
LICENCUAR; NDËRTESA, PAJISJE DHE GJITHË SISTEMIN E PRODHIMIT  
DHE SHPËRNDARJES), NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE  
ALBANIA” SH.A**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.07.2016.; pikës 1.3 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “HEC-i DRAGOSTUNJE” sh.p.k, për lënie peng asetëve të luajtshme dhe vendosje të hipotekës mbi ato të paluajtshme që do t’i përkasin “HEC –i Dragostunje”, (asete që do ti shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisje dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes), në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a, të përgatitur nga drejtoria e licencimit dhe monitorimit të tregut,

**Konstatoi se:**

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në *Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Asetëve nga të Licencuarit* si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 7 pika 3, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k për lënie peng të asetëve të luajtshme dhe vendosje të hipotekës mbi ato të paluajtshme që do t’i

përkasin “HEC –it Dragostunje”, (asete që do t’i shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisje dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes), në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a. (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**Lista e asetëve të luajshme dhe të paluajshme të lëna peng në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a., nga shoqëria “HEC-i Dragostunje” sh.p.k**

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
<b>1</b>	Pajisje Hidromekanike	--	--
<b>1.1</b>	Turbinë Pelton Vertikale	copë	2
<b>1.2</b>	Valvol flutur kryesorë me sistem by-pass	copë	2
<b>1.3</b>	Centraline Hidraulike	copë	2
<b>2</b>	Koni bashkues	copë	2
<b>3</b>	Xhuntoja për cmontim	copë	2
<b>4</b>	Pajisjet e gjeneratorit	set	2
<b>4.1</b>	Gjenerator tre fazor sinkron	copë	2
<b>5</b>	Sistem kontrolli dhe mbrojtje me PLC	set	2
<b>6</b>	Pjesët elektrike të tensionit të mesëm	set	2
<b>7</b>	Celat e tensionit të mesëm	set	2
<b>8</b>	Transformatori rritës	copë	2
<b>9</b>	Transformatori i nevojave vetiake	copë	2
<b>10</b>	Panelët e furnizimit AC dhe DC	set	2
<b>11</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çertifikatë për vërtetim titulli “Në Përdorim” të pasurisë nr. 529, Vol 08, Faqe 105 Librazhd Dragostunje.</li> <li>• Kartela e pasurisë së paluajshme Vol 8, Faqe 105 pr zonën kadastrale 1527, Nr. i pasurisë 529, lloji i pasurisë Përrua.</li> </ul>	-	-
<b>12</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çertifikatë për vërtetim titulli “Në Përdorim” të pasurisë nr. 530, Vol 08, Faqe 106 Librazhd Dragostunje.</li> <li>• Kartela e pasurisë së paluajshme Vol 8, Faqe 106 pr zonën kadastrale 1527, Nr. i pasurisë 530, lloji i pasurisë Pyll.</li> </ul>	-	-